

Drejtor i Përgjithshëm: Petrit BECI
Drejtor i Radios: Alfons ZENELI



Orkestra

Violina e parë

Blerita JAKOVA**
Spartak SINAMATI**
Edmea KRASNIQI
Mimoza MUÇO
Elda DONO
Laura AHMATAJ
Behexhet DARSUA
Enkelejda SHEHU
Marisa HATIBI
Ehsen ZAJMI

Violina e dytë

Gugash BALENA*
Jadvina VANI
Alma SHEHAJ
Anila ÇUNI
Selida PLAVA
Gerard KOLAGJOKA
Violeta GJONDEDA
Alma SEFERAJ
Lirza ZALOSHUJA
Nevila DERGUINI

Viola

Eleva KATROSHI*
Fatmira KOKO
Albana MNERI
Albana AXHA
Agim HASANI
Greta PRUSHA
Viola LUCA

Violonçel

Aristidh PROSI*
Ardian RESULI
Evis ZDRULI

Gezim BELEGU
Florian BINERI
Andi ALIMEMAJ

Kontrabas

Agim FILJA*
Artur STAFASANI
Rezat DOSTI

Flaut

Jonela GOLEMI*
Rozana KUKA
Edlira MOSHO

Oboe

Ermir GRUDA*
Nikolle MIRAJ

Klarinetë

Sokol TOTD*
Hysen HOTI

Fagot

Piro SOTA*
Usen MALAJ

Korno

Andrea CANAJ*
Arbër NEZIRI
Shemshedin VENDRESHA
Kristofor QORRI

Trompa

Gazmor HALILAJ*
Reinald FOÇI
Dilaver LELO

Trombon

Ismet KETA*
Dorian LLANGA
Andi KROQI
Dashamir HYSA B.tuba

Perkusion

Gridi KRAJA*
Eldi SMAJA
Nikolla STRAKOSHA

Sintetizator

Erga HALILAJ

Dirigjenti:

Menaxher:
Redaktor muzikor:
Mjeshtër zëri:
Kordinator:
Grafika:
Redaktore televizive:
Regjisor:

Jatmir Barbutushi
Dr.Oleg Anapi
Armando Volaj
Francisk Radi
Agron Vreto
Agim Lubonja
Albert Thoma
Sonila Djepashia
Leonard Gjata

KONCERT VOKAL – SIMFONIK

ORKESTRA SIMFONIKE E
RADIO TELEVISIONIT SHQIPTAR



ME MBESHTETJEN E TYLOLHOT



PROGRAMI

FRANZ LISZT
Mephisto - Walzer

RICHARD WAGNER

Wesendonk Lieder, 5 romanca për mezzosoprano e orkestër

FRANZ LISZT
"Totentanz" për piano e orkestër

JOHANNES BRAHMS
Simfonia No.1, op. 68, C minor

Soliste

VIKENA KAMENICA Mezzo-soprano
MERITA REXHA (TERSHANA) - Pianoforte

Dirigjent

DENIOLA KURAJA

Drejtor Artistik

DAVID TUKIÇI

UNIVERSITETI ARTEVE
E PREMTE 4 NENTOR 2011 ORA 19:00



DENIOLA KURAJA- dirigjent

Lindi ne qytetin e Durrësit, mesimet e para në piano i mori në moshën 6-vjecare në shkollën "Jan Kukuzei" nën drejtimin e pianistes Irma Picari, mësuases Shpresa Tafaj, duke dhene koncerte qe ne moshe te vogel. Akademine e Arteve e kreu me Prof. Anita Tartari kanë qenë mjaft të pasura me aktivitete kulturore-muzikore, masterkurse, çmime dhe vleresime. Në konkurse të ndryshme është fituese e disa cmimeve si: çmimi i parë në festivalin kombëtar "Pianisti i Ri", tre herë fituese e çmimeve të treta në konkursin "Česká Zadeja", "Tonin Harapi" dhe e vlerësuar me diplome në konkursin "Nikolla Zoraj" . Ka marrë pjesë në konkurse ndërkombëtare (1992-1998), masterklase , në javën e muzikës moderne Vjeneze në Vjene (1997-2001), një turne koncertesh recitale në Gjermani (1999) si dhe pjesëmarrëse në shumë aktivitete të zhvilluara në Tiranë si: "Festivali i Chopinit", "Vjeshta e Tiranës" etj. Në vitin (2006) "Instituti Italian i Kultures" i ofron një bursë specializimi në :Conservatorio di Musica N. Puccini ne Bari (Itali). Nga interpretimet me orkester mund të përmendim koncertet: TKOB-it nën drejtimin e Alqi Lepuri, RTSH nën drejtimin e Zhani Cikos, TKOB-it nën drejtimin e Rifat Teqja. Pas studimeve do ta pasuronte formimin e saj artistik me një eksperiencë prej 7-vjetësh si Korepeditore prane TKOB-it dhe Akademise së Arteve, duke qenë përhëre e pranishme në skenë. Dëshira për të zgjeruar interesat do te sherbente për të synuar jashtë kufijve të vendit e cila ju realizua me angazhimin si Korepeditore në Hochschule für Musik Theater und Medien Hannover (Gjermani 2008). Duke pasur gjithnje objektiva dhe pikësnyime si dhe për tu shprehur ne një menyre tjetër fiton te drejten e Masterit per Drejtim Orkestre (Dirigjim) (2009-2010). Nga Eksperiencat si drejtuese Orkestere do te permendim: Stadtstheater Orchester Hildesheim (Gjermani), Duna Symphony Orchester Budapest (Hungari), TKOB-it asistent-dirigjent "Perrallat e Hoffmannit", "Vejusha Gazmore" si dhe "Gala Koncert"



VIKENA KAMENICA-mezzo-soprano

Ka mbaruar studimet e larta ne vitin 2001 per Canto prane Akademise se Arteve. Ka mbrojtur diplomën me vlerësim maksimal ne koncert me orkester nen drejtimin e dirigjentit Bujar Llapaj. Aktualisht eshte soliste pranë Teatrit te Operas dhe Baletit ku ka marrë pjesë ne te gjitha veprat dhe koncertet te organizuara nga ky institucion. Qe nga viti 2001 shenohen disa role brenda dhe jashte shqiperise ne produksione te ndryshme si ; Suzuki – Madama Butterfly PUCCINI, Cherubino-Le nozze di Figaro MOZART, Fidalma – Il matrimonio Segreto CIMARROSA, Dama Pitchem-Die drei groschen oper WEILL, Anita – West Side Story BERNSTEIN, Siebel-Faust GOUNOD, Carmen – Carmen BIZET, Prinz Orlovsky – Die Fledermauss J. STRAUSS, Rosina – Il barbiere di Seviglia

ROSSINI, Alisia – Lucia di Lammormor DONIZETTI, Mag Page- Falstaff VERDI, Maddalena – Rigoletto VERDI, Giovanna Seymour – Anna Bolena DONIZETTI, Nicklaus/La Muse – Les Contes d'Hoffmann OFFENBACH, Charlotte – Werther MASSENET. Ne veprat vokalo sinfonik shenojme El amor brujo DE FALLA si dhe ciklin e liederve Winterreise SCHUBERT me pianisten Merita Rexha .Koncert recital NAPOLETANA me orkestrën e prof. te A.A. Les Temps de Cerises me Luiza Xhuvanin dhe Ndrim Xhepa. Ka bashkepunuar me dirigjent si Ermir Krantja, Vittorio Parisi, Fabio Pirona, Davide Crescenzi, Gloria Ramos Triano, Andre Bernard, Manfred Mayrhofer, Gianluca Martinenghi, Giana Frattara, Marco Berdondini, Jerome Devaud. Si dhe me regjisor si : Mihallaq Luarasi, Patricia Pantoni, Nancy Rhodes, Alexander Radulescu, Massimo Ranieri, Paul Flieder, Nicola Zorzi, Eleonora Patterni, Claud Montagne, Stephane Roche .Burse 2 vjecar ne CEE Musik – Theater me qender ne Vjene 2005-2006. Master ne Universitetin Mozarteum Salzburg Austri ne 2009. Fituese e Cmimit te Dytë te Konkursit internacional Hummel Competition ne Salzburg 2009. Fituese e Cmimit te Pare te Konkursit Internacional "Humor, Joke and Ironi in Music" Salzburg 2009



MERITA REXHA TERSHANA- pianiste

Eshtë një nga pianistet me aktive të jetës muzikore shqiptare. Ka mbaruar studimet për piano ne Tiranë, ne liceun artistik nen drejtimin e N. Porodinit dhe Akademine e Arteve me Prof. M. Kristidhi. Me pas ka ndjekur disa kurse perfeksionimi ne Gjermani me pianistin e nivelit botëror Paul Badura Skoda dhe prof. e Folkwang Hochschule Essen Till Engel. Merita Rexha Tershana ka koncertuar si soliste me orkestrat kryesore ne vend, ne drejtimin e dirigjenteve shqiptare e te huaj. Eshte ftuar si soliste dhe ne asamble te muzikes se dhomes ne shume Festivale te rendesishme, si Schleswig-Holstein Music Festival-Gjermani, Bregenzer Festspiele-Austri, Kamermusik Festival Kosove, si dhe ka koncertuar si soliste ne Gjermani, Austri, Danimarkë, Itali, Greqi, Maqedoni.

Repertori i saj perfshin vepra te literatures pianistike nga Baroku deri ne muziken bashkohore. Ka luajtur disa premiera te veprave te kompozitoreve shqiptare bashkohore, si dhe ne Festivalin "Vjeshta e Tiranës" integruar e veprave te kompozitorit Xenakis para vete autorit. Ka regjistruar disa cd, me vepra te kompozitoreve shqiptare si dhe ne vitin 2009 me vepra te Schumann-it. Eshte nderuar me cmime te ndryshme si Interpretuesja me e mire e vitit, Festivali i Muzikes se Re Shqiptare 1996, nominuar per cmimin Interpretuesja me e mire ne Cmimet Kult ne vitet 2004, 2006, 2008, dhe fitues e cmimit Kult per vitin 2009. Në vitin 1994 fillon pune si pianiste ne Akademine e Arteve dhe që prej vitit 2002 jep piano principale në Katedren e Pianos. Në vitin 2007 merr titullin Ass. Prof.



Gjeniu i muzikës Franz Liszt –Kompozitor – pianist – mësues – në 200 vjetorin e lindjes.

Lindi para 200 vjetësh me 22 tetor 1811 në fshatin hungarez Raiding dhe përpara 125 vjetësh me 31 korrik 1186 ai ndërroi jetë në Bajrojt. Sipas legjendes se familjes qysh para lindjes ishte parashikuar gjenialiteti e Franz Liszt-it. Një cigane duhet ti ketë profetizuar nënës së tij shtatzëne me shfaqjen e kometës së madhe se në vitin 1811 do të lindte një djalë të destinuar për madhësi. Kjo profeci u vërtetua plotësisht, mbasi prinderit shumë shpejt ishin te vetëdijshëm për dhuntin e jashtëzakonshme të djalit të tyre. Në vjeshtën e vitit 1820 Liszt si nëntëvjeçar u prezantua për herë të parë në publik në Edenburg/Sopron dhe në Presburg/Bratislavë si interpretues dhe improvizues. Ai

vendosi kontakte me dijetare të mëdhenj si Victor Hugo Honore de Balzac dhe Heinrich Heine. Por influencën me të madhe ai e pati nga iluministi Abbe Felicite de Lamennais. Pas viteve me aktivitete të shumta artistike dhe turbullira private në Zvicër, Itali e Gjermani ai u vendos me të dashuren e tij Carolyne zu Sayn-Wittgenstein në Romë. Këtej e tutje Liszt iu përkushtua intensivisht muzikës sakrale. Volumi i veprave të tij muzikore të inspiruara prej besimit është i jashtëzakonshëm. Krahas 65 veprave korale kishtarë bëjnë pjesë edhe kompozimet religjioze për piano. Vepra më e shquar është "Messa solemnis" 1856 e cila krahas meshës së Anton Bruckner-it konsiderohet ndër veprat kulmore të muzikës kishtarë të shekullit të 19-të. Liszt është konsideruar nga bashkëkohësit e tij si kompozitori dhe pianisti më i madhë i të gjitha kohërave. Si kompozitor ai ishte një nga përfaqësuesit më të shquar të "Schule Neudeutsche" (shkolles së re Gjermane). Disa nga kontributet e tij më të shquar ishin shpikja e poemës simfonike, zhvillimin e konceptit të transformimit tematik, si pjesë e eksperimenteve të tij në formën muzikore dhe duke bërë një nisje radikale në harmoni. Gjatë një udhëtimi për në festivalin e Wagnerit ne Bajrojt më 31 korrik 1886 Liszt ndërroi jete. Pak dite më pas me 3 gusht ai u varros në Bajrojt.

Franz Liszt – "Mephisto – Walzer" përbëhet nga katër valse që u kompozuan nga Liszt në vitet 1859-62, 1880-81, 1883 dhe 1885. Valsi Nr.1 dhe 2 janë kompozuar për orkestër dhe më vonë u orkestrua për pianoforte, kurse 3 –4 janë shkruar për piano solo. Nga katër valset, i pari ka qënë më popullori, më i ndjekuri dhe më i transmetuari.

Franz Liszt – "Totentanz" ose (Vallja e Vdekjes) është një dans makabër për pianoforte e orkestër nga Liszt, i cili është i dukshëm për të qënë i bazuar në stilin Gregorian, të cilën na e ekspozon me një risi stilistike të gaximshme. Liszt e filloi punën për këtë vepër më 1838 dhe e përfundoi më 1849.



Simfonia No.1, Op. 68, në C minor, është një simfoni nga Johannes Brahms, i cili shpenzoi një kohë të madhe prej 14 vitesh për kompletimin e kësaj vepre. Premiera e kësaj simfonie u shfaq më 4 nëntor 1876 në Karlsruhe (gjermani), drejtuar nga miku i tij kompozitori Felix Otto Dessoff.

Simfonia ka katër kohë;
Koha e I-rë - Un poco sostenuto – Allegro – Meno allegro
Koha e II-të - Andante Sostenuto
Koha e III-të – Un poco allegretto e grazioso
Koha e IV – Adagio – Piu andante – Allegro non troppo, ma con brio – Piu allegro



Wesendonk Lieder, 5 romanca për mezzosoprano e orkestër nga Richard Wagner